




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Procesverbal

Nga Seanca e dymbëdhjetë (XII) e Kuvendit të Komunës së Gjilanit , mbajtur më 31.1.2011 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit me këtë:

Rend pune:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga Seanca e kaluar
2. Betimi solemn i anëtarit të rinj të Kuvendit

3. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

3/1- Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2010

3/2- Propozim –vendimi për kompensimin e Kolegjiumit të shfave të grupeve të këshilltarëve për caktimin e anëtarëve të KK-së, në komisionet mbikëqyrëse, pranime teknike të projekteve kapitale dhe të komisioneve tjera të KK-së

4. Të ndryshme

Seanca filloi punimet në ora 12. 20 min.

Kryesuesi i Kuvendit

Z. Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e seancës ishin ;

Anëtarët e kuvendit

Përfaqësuesit e OSB-së

Drejtorët e drejtorive komunale

Mediet

Seancën e dymbëdhjetë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit z. Izmi Zeka i cili fillimisht e përshëndeti kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, OJQ-të të cilat janë të pranishme dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

Në fillim të seancës kryesuesi kërkoi nga sekretari për ta verifikuar prezencën e anëtarëve të Kuvendit.

Sekretaria konstatoi se në këtë seancë janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit

Në fillim kryesuesi i njoftoi këshilltarët që në ora 19 të marrin pjesë në përmbyllje të “Flakës së Janarit” i cili manifestim u mbajt me dinjitet.

Nëse ka për të shtuar dikush lidhur me rendin e punës mund të thotë diçka edhe pse ne jemi dakorduar me këtë rend me shefat e grupeve parlamentare.

Shpresë Jahiri- znj. Jahiri theksoi se qytetarit Xhevat Jahiri iu është djegur shtëpia në muajin janar nga pasojat e rrymës elektrike, në të cilën shtëpi kanë jetuar dy familje me 13 anëtarë, familja e Xhevatit dhe ajo e vëllait të tij të ndjerë.

Komiteti i jonë është angazhuar dhe i ka strehuar këto dy familje, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme, prandaj kërkoj nga ky Kuvend që t’i del në ndihmë kësaj familje.

Arben Mehmeti- në të ndryshme i kemi disa çështje në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, kjo të jetë si paralajmërim.

Elisah Ymeri- unë e kam një vërejtje, sepse ne vetëm po e themi nën të ndryshme, kurse në fakt asnjëherë nuk po debatojmë. Ju lus që këto nën të ndryshme t’i debatojmë.

Shkëlqim Latifi- unë kam vërejtje, sepse Raportin e punës së kryetarit nuk e kam marrë, si duket edhe disa kolegëve të mi i ka ndodhur kështu. Nuk e di se për çfarë lëshimi është fjala?

Izmi Zeka- materialet i kemi dërguar me një ditë vonesë, por ato janë dërguar në secilën parti politike. Sa i përket rastin që e paraqiti znj. Shpresë është mirë t’i drejtohet drejtorit të Shëndetësisë i cili do të shikojë mundësinë për ta ndihmuar këtë familje.

Mimozë Kadriu – pasi që unë jam anëtare e komisionit për çështje sociale e njoh rastin për të cilin e paraqiti znj Shpresë, sepse ka qenë kërkuese për banesë për raste sociale, prandaj ne e kemi futur në prioritet për ndërtim të një shtëpie tjetër, sepse trollin e posedojnë, por edhe e kanë filluar shtëpinë e cila e ka vetëm një pllakë, kurse tash i ka ndodhur edhe më keq, por ajo familje ka edhe fëmijë jetimë.

Jam e mendimit se duhet pasur parasysh këtë rast.

Arben Mehmeti- një këshilltar nga grupi i LDK-së është tërheq nga pozita e këshilltarit komunal, kurse në vend të tij do të jetë Nevzad Rushiti

Qemajl Mustafa- ju e dini se Komuna nuk posedon fonde për intervenime të kësaj natyre, bile jo asi fonde të vëllimshme për t’i ndërtuar dikujt shtëpi, sepse nuk ka aso lloj subvencionimi dhe asi lloj kodi.

Ne i kemi ndihmuar me nga një lloj subvencionimi me nga një shumë të vogël, ata që janë atakuar nga fatkeqësi të tilla, dikujt 500, dikujt 1000 mijë euro etj, por me një arsyetim.

Mirëpo nuk ka fonde të vëllimshme që dikujt ’i ndërtohet një shtëpizë prej 10-15 mijë euro, ashtu siç po veprohet tek programi për kthim për romë dhe serbë.

Disa raste ne i kemi rehabilituar përmes komunitetit të biznesit dhe vëllimi i investimeve vetëm në një rast në Shurdhan është 10-15 mijë euro. Por kemi edhe dy tri raste në Arbëri siç janë

kulmet e shtëpive etj. Ne kështu do të bëjmë përpjekje bashkë për ta gjetur ndonjë donatorë i cili do ta ndihmojë këtë rast.

Unë iu premtoj se do të angazhohem për këtë rast e sa do t'ia dalim nuk mund ta caktoj sot.

Izmi Zeka- ju lus të deklaroheni kush është për këtë rend pune me ato sugjerimet që u bën?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të këshilltarëve

Procesverbali nuk pati vërejtje

2. Betimi solemn i anëtarit të rinj të Kuvendit

Sadri Arifi- z. Kadir Hysein, këshilltar nga grupi parlamentar i KTDP-së ka dhënë dorëheqje, kurse në vend të tij sipas radhës vjen Selim Selimi, të cilin e thërrasim për ta nënshkruar betimin.

Z. Selim Selimi e bënë betimin para këshilltarëve komunal

Sokol Haziri- z. Kadër ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit, por kjo kuptohet se ai duhet të lirohet edhe nga posti i zv/kryesuesit për të cilin rast duhet biseduar në seancën e radhës.

1- Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2010

Izmi Zeka- ky raport është debatuar gjerë e gjatë në KPF, por është e nevojshme që edhe para këshilltarëve të debatohet për këtë raport, sepse ne gjatë tërë kohës po mundohemi që të jemi transparent, sepse disa gjëra po shkojnë në skajshmëri. Fjalën do ta ketë kryetari i Komunës.

Qemajl Mustafa- në fillim të fjalës së tij kryetari i përshëndeti të gjithë këshilltarët dhe të pranishmit e tjerë në sallë duke theksuar se demokraci nuk ka asnjëherë mjaft dhe nuk ka tepër, por po ndodh që në Kuvend po debatojmë gjatë dhe i njëjti këshilltar disa herë për të njëjtën çështje. Ne kemi debatuar në KPF, por një pjesë e madhe nuk është në këtë komitet, prandaj është e rrugës që në mënyrë telegrafike, prapë të epet raporti i punës.

Në vijim të fjalës së tij kryetari i Komunës filloi për ta lexuar raportin para këshilltarëve, por herë pas herë duke u ndaluar në disa çështje dhe duke dhënë komente të hollësishme, të cilin raport, anëtarët e Kuvendit e kanë pasur së bashku me materialin për seancë.

Pas raportit të kryetarit, kryesuesi e hap debatin, duke theksuar se secili që e merr fjalën të jenë sa më të shkurtër dhe konkretë, sepse është debatuar gjatë dhe janë dhënë vërejtje dhe sugjerime të mjaftueshme.

Sokol Haziri- unë në emër të grupit të AAK-së do t'ia paraqes vërejtjet e mia të cilat i kemi në këtë raport: e para është forma dhe përmbajtja e raportit, të cilat vërejtje i kemi dhënë edhe në KPF. Në fakt nuk e pashë askund se ky raport i drejtohet këshilltarëve të KK-së, por është raport sektorial që i drejtohet kryetarit, pra do të duhej që të kishim një raport më të shkurtër, ku në hyrje do të duhej të ishin ato gjërat e përgjithshme dhe në pjesën tjetër raportet sektoriale të cilat i mbulojnë drejtoritë. Gjithashtu do të duhej raporti në emër të kryetarit t'ia drejtohet KK-së.

Raporti do të duhej të ishte shumë më i shkurtër, sepse puna tregohet me pak fjalë dhe të preken vetëm ato pika ku janë bërë investimet dhe sa me kujdes është harxhuar buxheti dhe do të ishte i mjaftueshëm një raport prej 20 faqeve.

Te shëndetësia po ndalem pak dhe po theksoj se shëndetësia primare ka lëviz bukur mirë, karshi kësaj terciare e cila nuk është askund. Unë do ta inkurajoj drejtorin që shtojë intensitetin e punës dhe të shtojë kontrollin edhe jashtë orarit të punës dhe të shtohet disiplina në këtë sektor.

Unë e di që nuk është në kompetencë të Komunës, por e lus kryetarin që ta ushtrojë autoritetin e tij, sepse një e keqe e madhe po ndodh në Spitalin Regjional të Gjilanit, sepse çdo hyrje me automjet në oborr të spitalit, qytetarit i kushton një euro, por nëse hyn tri herë tri euro!

Mua më ka ndodh kjo, por edhe më keq është se ka pasur sjellje të vrazhdë të personelit (rojës fizike), prandaj kjo pagesë duhet t' i hiqet qytetarëve të Gjilanit. Mirëpo kështu ka ndodhur edhe me një pjesëtar të Familjes së Dëshmorëve, të cilat me ligj janë të liruar nga shumë pagesa.

Te Administrata iu përgëzoj për hapat që janë ndërmarrë, por ka nevojë shumë më tepër për t' u bërë. Unë kam pasur rast për t' i nxjerr disa dokumente dhe kam parë dhe përjetuar një pritje më tepër se një orë për shkak të ngadalësisë së kompjuterit, në një zyre të vendit. Kërkoj që kësaj t' i kushtohet kujdes më të madh, sepse kompjuteri "pentium" 1,2 dhe 3 i takojnë së kaluarës.

Tjetër është se në Kishnapolë dhe Verbicë nuk ka rrjet fare dhe banorëve të atyre fshatrave iu duhet të vijnë në Gjilan 2-3 herë brenda një jave.

Sidoqoftë është bërë mjaft, por ka për t' u bërë shumë, prandaj raportet të jenë më të qarta dhe të theksohet se për secilën drejtori sa janë të arriturat.

Këto janë vërejtjet e mia gjenerale në emër të AAK-së.

Arben Mehmeti- edhe ne shumë gjëra i kemi thënë në KPF, prandaj këtu do të jem më i shkurtër, por kontribuoi edhe z. Sokoli për të qenë i tillë.

Raportin të cilin e bërë kryetari është një raport ku flitet vetëm për punë të mira të kësaj Komune, kurse realisht nuk kemi vërejtur diçka me të cilat ka qenë desh kryetari të merret më tepër. Në vitin 2010 ne kemi pasur bastisje të zyrave të Komunës nga eulexi, e cila gjë fare nuk figuron në raport, të cilin fakt kryetari ka qenë desh ta pasqyrojë në pika të shkurtra.

Po ashtu në vitin 2010 ka pasur vërejtje sa i përket fushës së prokurimit nga ana e atyre që merren me monitorimin e kësaj fushe.

Gjithashtu në raportin e kryetarit ka qenë e nevojshme të kemi edhe një pasqyrë të borxheve për vitin 2010 dhe të dihet sa borxhe i trashëgon Komuna në vitin 2011, për vitin 2010, për punët të cilat kanë përfunduar?

Te projektet nuk u përmend, por indirekt u theksua se projektet janë realizuar prej komisioneve politike dhe në çdo komision ka qenë një numër i madh nga radhët e PDK-së. Do të ishte mirë që kjo praktikë në të ardhmen të ndryshojë dhe kryetari duhet të jetë i paanshëm.

Gjithashtu i kemi disa vendime të cilat i kemi nxjerr në Kuvend, por të cilat nuk janë duke u zbatuar në praktikë? Si shembull janë hapësirat publike, për të cilat e kemi nxjerr vendimin për lirim të atyre hapësirave dhe deri më tash nuk kemi pasur zbatim konkret.

Kryetari e tha në raport se investime në Komunë janë afërsisht 11 milion euro, por sipas Zyrës së Prokurimit, figuron shifra mbi 7 milion. Është mirë të harmonizohen disa shifra, sepse nuk ka përputhje në mes të raportit të kryetarit dhe Zyrës së Prokurimit lidhur me investimet vetanake dhe ato të grandeve qeveritare, sepse këtu mungon një baraspeshim i vlerave.

Një vërejtje shumë serioze për kryetarin e Komunës është për çështje të tenderëve gjegjësisht të kompanive publike të cilat marrin punë në KK- të Gjilanit. Është vërejtje e jona serioze, sepse

kompanitë gjilanasë nuk trajtohen si duhet dhe janë 59 kompani të cilat kanë fituar tender jashtë Komunës së Gjilanit?

Është thënë se është paguar qira për 25 familje dhe po vazhdojmë me këtë proces edhe për 25 të tjera, prandaj kërkojmë listën e atyre familjeve se cilave i kompensohet qiraja?

Gjithashtu edhe çështja pakove ushqimore, të na dërgohen listat të nënshkruara dhe të vulosura, sepse kam njohuri se ato lista janë keqpërdorur në terren, nga komisionet partiake në lagje dhe fshatra.

Tek sporti ka pasur disa investime dhe ka pasur disa donacione për disa klube, por do të ishte e mirë ta kemi një informatë se për cilat klube bëhet fjalë dhe cilat kanë ndihmuar gjatë vitit 2010?

Në raport përmendet se gjatë vitit 2011 do të bëhen investime në tri hyrje të qytetit të Gjilanit, e cila është një punë mjaft e mirë, por këtyre tri hyrjeve duhet t' i shtohet edhe hyrja e Preshevës?

Në fund po theksoj se kryetari është mirë që të angazhohet shumë më tepër me çështjen e deponisë, sepse ajo deponi është në gjendje të rëndë dhe qytetarët janë të rrezikuar nëse nuk merren masa të shpejta të veprimit.

Zijadin Maliqi- unë do të flas në emër të timin dhe jo të grupit tim! Të gjitha raportet i kam lexuar dhe jam munduar ta bëj një analizë profesionale nga lëma e ime.

Së pari raporte të zyrave nuk kemi fare raport, me përjashtim të Zyrës së Prokurimit e cila është në rend pune nesër.

Në raport të kryetarit çdo gjë është pozitive, me përjashtim të një vërejtje ku thuhet se kemi një degradim të projekteve, por faji i hudhet organit mbikëqyrës.

Unë e kam thënë edhe më parë se tek organet mbikëqyrëse dhe tek ato të pranimi teknik, kemi njerëz jashtëzakonisht joprofesional. Shihet edhe në raportin e Zyrës së Prokurimit se në çdo projekt është i njëjti njeri dhe a degradohet rruga për disa muaj apo ditë, nuk i intereson askujt! Projekte ka shumë dhe theksoj se janë realizuar ose janë në realizim e sipër, por Zyra e Projekteve ka qenë desh të na jep një pasqyrë sa janë realizuar dhe sa janë në procedurë, por edhe një pasqyrë edhe për vitin e ardhshëm?

Tek auditimi nuk kemi asnjë raport me përjashtim të atij të vitit të kaluar, por ajo edhe më keqja është se nuk kemi raport as nga auditori gjeneral dhe asnjëherë nuk është bërë një prezantim i tillë para Kuvendit?

Te buxheti e kam thënë edhe më parë se nuk jam i kënaqur me buxhetin nga grandit qeveritar, por nuk jam i kënaqur as me rishikim të buxhetit për vitin 2010 dhe jam i mendimit se për vitin 2011 Qeveria duhet të ketë më tepër konsideratë.

Tek drejtoritë janë dhënë raportet, por pjesa më e madhe i kanë bërë edhe planet e punës për vitin 2011, kurse 3-4 drejtori nuk i kanë planet.

Në ato drejtori ku jam anëtar i komitetit, vërejtjet i kam dhënë atje, por tek Administrata është në lëshim në faqe 2: theksohet numri i lëndëve dhe të dhënave, por është harruar pasqyra e të dhënave? Tek Autoparku është një pasqyrë detale e automjeteve, por tek disa automjete që janë personale shihet se ka një kilometrazh mjaft të madhe! Mandej janë disa automjete me një vjetërsi bukur të madhe, prandaj ka shpenzime të mëdha.

Tek Arsimi një pyetje për drejtorin: “ a është në dijeni se kemi paralele me 46 nxënës dhe ora zgjat 30 min?

Ejup Haziri- unë e dua një sqarim nga Arbeni, nëse nuk e kam keqkuptuar! Kur z. Arbeni i përmendi komisionet tha se: “ në këto komisione janë të përbëra me shumicë prej PDK-së”.

Mirëpo unë e di se për komisione dhe formim të tyre e kemi përdorur një çelës partiak. Dua një sqarim për çfarë komisione është fjala?

Arben Mehmeti- është fjala kryesisht për ato në terren, të cilat bëhen krejtësisht prej një subjekti të caktuar!

Rashit Sahiti- së pari dy pyetje për drejtorin e Arsimit: “ pse në Shkollën “A. Ajeti” në gjysmë vjetorin e dytë nuk mbahet mësimi ose mbahet jo rregullisht dhe a ka njohuri se në Malishevë sot nxënësit janë kthyer në shtëpi, sepse nuk funksionon nxehja qendrore?

Në raport thuhet se mësimi në Komunën e Gjilanit mbahet në katër gjuhë, shqipe, turke, serbe dhe rome! Mendoj se dy të fundit nuk janë në sistemin e Republikës së Kosovës.

Thuhet se e kemi marrë një vendim për ruajtje të vendeve të punës për drejtorët e zgjedhur! Mirëpo duhet të theksohet edhe të atyre paraprak, sepse ashtu është nxjerr vendimi! Ky vendim ende nuk është zbatuar, sepse kanë mbetur edhe disa drejtorë për pa u sistemuar.

Duhet të na epet një përgjigje pse ka nxënës të pavlerësuar, a e kanë lënë shkollën këta nxënës apo çka ka ndodhur me ta?

Thuhet se në shkollat e mesme janë regjistruar të gjithë nxënësit e interesuar, por unë mendoj se këtu është bërë një regjistrim jo i mirë, sepse ka shkolla që i kanë mbi 45 nxënës në paralele, kurse në disa shkolla të tjera ka paralele me 20 e më pak nxënës!

Nuk janë shpërndarë të gjitha tekstet shkollore siç thuhet në raport e kam thënë edhe më parë!

Thuhet se është bërë zgjedhja e 6 ud. ë drejtorëve për minoritetin serb! Më intereson prej kujt është bërë ky emërim? Mandej këta drejtorë ud. a e kanë pranuar plan- programin e Republikës së Kosovës?

Vlerësimi i nxënësve sipas niveleve është shumë i larmishëm, sa më lartë niveli, nota mesatare më e dobët. Në Gjimnazi, nota mesatare 3.2, sukses shumë real, ajo e mjekësisë 2.95, ajo ekonomike 2.44, kurse ajo teknike 2.02 dhe ajo “Arbëria” 2.60.

Mendoj se në shkollë teknike punojnë inxhi, të cilët nuk kanë pasur lëndë pedagogjike, por e kanë bërë një vlerësim më objektiv në krahasim me disa shkolla të tjera.

Numri i mungesave është i madh, shumë shkolla punojnë në tri ndërrime dhe ora zgjat 30 min, por sukseksi del mjaft i mirë. Vetëm në Shkollën “M. Isai” ora zgjat 40 min dhe vlerësimi është objektiv. Unë konsideroj se sukseksi është i fryrë!

Në raport nuk janë përfshirë orët e humbura dhe a janë marrë masa për këtë qëllim, do të thotë për arsimtarët të cilët nuk i kanë mbajtur orët?

Jashar Jashari – z. Jashari gjatë ekspozeut të tij lidhur me raportin e punës së kryetarit u orientua më tepër në raportin e Drejtorisë së Shëndetësisë, aty ku jep kontributin e tij si mjek në Spitalin Regjional të Gjilanit. Në fjalën e tij z. Jashari pati mjaft sugjerime, por edhe mirënjohje, por ai këto i deponoi me shkrim në sekretari të cilat vërejtje do t’ i bashkëngjiten procesverbalit.

Sabedin Kadriu- pas një përshëndetje që ia bëri të gjithëve, z. Kadriu theksoi se kam dëshirë që Gjilanin ta pagëzoj me një emër “ Hani i”, por ende nuk ia kam gjetur mbiemrin, sepse këtu hyn e del kushdo dhe nuk di askush se çka ndodh! ?

Sa i përket raportit të kryetarit, unë e përshëndes, sepse ka vetëm fjalë miradije dhe lëvdata, por unë do të flas për disa drejtori.

Në radhë të parë Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet ta ketë një mbikëqyrje më të mirë rreth punëve në trotuare dhe saktë të caktohet vendi ku duhet të jetë për mbeturina, sepse kjo si është kështu, është marri. Mbeturinat gjenden vend e pa vend dhe ata që kanë pasur rastin të dalin pas KEK-ut e shohin se si oborri është i mbushur me mbeturina.

Drejtoria tjetër në të cilën do të koncentrohem është ajo e Inspeksionit dhe në bazë të asaj që po thuhet ose unë kam gënjyer ose ky tjetri po gënjen! Unë kam prit që në kuadër të raportit të kryetarit kam prit ndonjë vërejtje nga kryetari që ia ka shqiptuar Inspeksionit? Mua më ka ndodh kjo, vetëm pse nuk i kam larguar tavolinat tek kompleksi i shkollave të mesme, sepse kam qenë në pushim veror dhe nuk kam mund me datë të saktë ta zbatoj atë urdhëresë.

Vërejtje të dytë kam marrë nga kryetari i cili më ka akuzuar se gjëja unë jam goditur me qytetarin e cila gjë nuk qëndron, por i kam dhënë hapësirë qytetarit i cili ka ardhë në pushim nga përendemi edhe për ta ndërtuar shtëpinë, por edhe për ta marrë lejen!

Në këtë raport që po e debatojmë sot, nuk është dhënë asnjë vërejtje, kur dihet se një pompë e benzinës është ndërtuar pa leje, në qendër të qytetit. Unë lidhur me këtë e pyes drejtorin e Urbanizmit i cili në atë kohë ka qenë zyrtar për leje dhe së paku 5 herë jam konsultuar me te lidhur me këtë pompë, i cili më ka thënë se aty janë disa parakushte, sepse duhet së paku largësi 20 m prej rrugës dhe nuk mund të pajiset me leje ai qytetarë.

Unë sot nuk pash se drejtori i Inspeksionit iu është dhënë vërejtje për këtë rast, prandaj unë jam në pozitë të rëndë pse e kam rrënuar atë objekt!

Në mbledhjen e ardhshme kërkoi raport me shkrim për këtë rast, si është ndërtuar ajo pompë dhe kush e ka lejuar? Gjithashtu edhe nga drejtori i Urbanizmit kërkoi sqarime se a kanë ndryshuar ato parametra apo jo?

Këtu në raport thuhet se Inspeksioni e ka bërë ekzekutimin e 20 garazheve,

Drejtori i Bujqësisë nuk e ka të qartë se është organ ekzekutive dhe nuk është organ që bie ligje, sepse ai e ka sjell një vendim për vend gjueti e cila drejtori nuk është kompetente ta bëjë këtë, por për këtë duhet marrë vendim KK.

U fol për organet mbikëqyrës, por është mëkat kur dikush brenda vitit i fiton 20-30 mijë euro, kurse rroga mesatare e këtyre këshilltarëve të cilët kanë vrapuar për ta fituar pushtetin është 170 euro. Për arsim e kam një rast ku në një klasë ka 45 nxënës dhe në fund të gjysmë vjetorit të parë kanë qenë 6 nxënës me nota të dobëta, por pyetjen të cilën ia kam bërë kujdestarit të klasës ka qenë: “A janë këta nxënës të cilët janë regjistruar pa meritë”? Përgjigja ka qenë po.

I sugjeroj drejtorit që nëse janë kriteret për 32 nxënës, mos të rritet numri për asnjë nxënës dhe atë në asnjë paralele!

Mimozë Shkodra- Bislimi- do t’ i them disa fjalë për raportin e DKRS-së ku thuhet se është pranuar projekti për Palestrën Sportive “B. Selishta” në vlerë prej 500 mijë eurove?

Shihet qartë se aty është bërë një intervenim, por aty është një ftohtë i madh deri në minus 17 gradë dhe nuk ka as ujë të ngrohtë. Mendoj se aty është bërë një investim i gabuar pa marrë parasysh mjeteve të cilat ekzistojnë.

Në raport thuhet se do të vazhdojmë me investime private tek palestra, por nuk e kam të qartë tek cila palestër, sepse këtu ka palestra të vogla të cilat janë për nxënës dha ajo e madhja “B. Selishta”, prandaj duhet të theksohet kjo?

Ajo sallë është vështirë të shfrytëzohet nga komuniteti sportiv për shkak të kushteve jo të mira, nuk ka pastërti dhe është shumë ftohtë.

Unë i thash këto vërejtje, sepse në Gjilan pritet që të vijnë një ekip sportiv nga Gjermania dhe Amerika me të cilat ekipe do të miqësohemi, por e kemi frikën se nuk do të kemi ku t’ i biem?

Kërkoj një sqarim për këto gjëra, ose nga kryetari i Komunës ose nga përgjegjësitë për sport?

Arben Maliqi- unë e përshëndes raportin e kryetarit të Komunës, sepse ai vlen të respektohet edhe pse ka pasur ende për të thënë, por në përgjithësi është një raport që ia vlen.

Unë do të përqendrohem si gjithëherë në arsim dhe sport. Pajtohem me kryetarin se klima politike dhe e sigurisë është në nivel dhe kjo është meritë e kryetarit, neve kuvendarëve, kryesuesit, partisë në pushtet, por meritë e madhe është edhe e opozitës.

Marrëdhënie të mira ka pasur me donatorët, por mund të presim edhe shumëçka sepse duhet t' i kemi njerëzit e tanë, ambasadorët tanë, të cilët do të na ofrojnë njerëz me të cilët do të bashkëpunojmë për t' i krijuar kushte të mira Komunës sonë.

Investimet po ndodhin si në infrastrukturë dhe në ato kapitale si është ai investimi i Lumit Mirusha i cili është projekt të cilin të gjithë duhet ta përshëndesim.

Mandej është një projekt- pilot i cili ka një rol të madh në lagjen ku jetoj unë, e ai është pilot projekti i Kompanisë “Higjiena” i cili ka bërë vendosjen e kontinjerëve dhe i ka eliminuar shumë dukuri negative. Mandej po ndërtojmë shkollë, por ato mos t' i lëmë në gjysmë dhe mos të harrojmë se duhet bashkëngjitur edhe diçka tjetër. Fjalën e kam për Gjimnazin dhe shkollën e Bujqësisë të cilat shkollë do të pajisen edhe me kabinete të ndryshme.

Mirëpo po theksoj se dhe partneriteti privato- publikë është kërkesë imediate dhe me ata njerëz që kemi punë duhet të jenë njerëz kredibil dhe serioz, por edhe me referenca të mira.

Gjatë punëve të cilat do të bëhen duhet të jemi të kujdesshëm të mos ngutemi, por as të mos vonohemi dhe ta bëjmë një punë ashtu siç na ka hije.

Kam disa vërejtje e konkretisht për fshatin Kosaq i cili fshat ka qenë një ndër më të dëmtuarit në luftë, por në këtë fshat nuk është bërë asnjë investim?

Unë drejtorët i kisha vlerësuar disa si drejtorë azhur, mesatar dhe disa premtues. Mirëpo para një viti e kam thënë se kryetari nuk i ka të gjithë drejtorët nën ombrellë, por këtë vit dhe mandat është e kundërta dhe të gjithë janë në ombrellë të kryetarit.

Në Administratë drejtori është duke e kryer punën siç duhet, me një angazhim solid, sepse po shihen rezultatet, mirëpo kështu janë edhe ajo e Kadastrit dhe ajo e Shërbimeve Publike, mandej ai i Emergjencës etj

Do të përqendrohem në Drejtorinë e Arsimit e cila lëmi është me shumë probleme, por këtu kanë ndodhur shumë gjëra të mira, si është ndërtimi i shkollave dhe sallave të sporteve, por ende jashtë standardeve evropiane. Duhet të punohet më tepër për të kaluar me mësim në dy ndërrime. Sa i përket suksesit të këtij gjysmë vjetori sa i përket stafit është i mirë, por duhet theksuar se shkollë Ekonomike suksesin nuk e ka 2.44, por 3.02, mandej nuk është potencuar aktivizimi i sportit shkollor i cili ka rëndësi të madhe për fëmijët tanë.

Në shkollë gjithashtu duhet të angazhohen pedagogët, psikologët dhe sociologët.

Lidhur me sportin po e theksoj se faji është i Qeverisë, sepse shumë pak ka ndarë mjete për aktivitete sportive dhe kulturore. Në emër të grupit të AKR-së e mbështesim raportin e kryetarit.

Shpresë Hajdari- do t' i them pak fjalë lidhur me raportin e kryetarit, por kryesisht për DKRS-në, sepse në këtë raport thuhet se Teatri ka pasur dy premiera gjatë vitit të kaluar, por vërteta është se aty i kemi pasur katër premiera.

Kam një vërejtje ku thuhet: “jemi në fazën e trupës prezantuese profesioniste muzikore të Komunës”. Gjilani ka nevojë ta ketë një trup profesioniste muzikore, sepse Gjilani ka kuadër, por këtu thuhet se kemi mungesë buxhetore për kulturë. Unë po pyes nga do t' i marrim këto

mjete për trupën profesioniste muzikore? Ne e dimë se kësaj drejtorie iu është shtuar edhe Biblioteka Rajonale me 14 punëtorë.

Mandej në raport thuhet se do të investohet në stadiumin të varrezat. Është menduar në ndonjë fushë të vogël futbollit apo fushë ndihmëse e stadiumit, sepse për stadium nuk ka hapësirë?

Ramaiz Ramadani- unë do të flas diçka shkurtimisht vetëm për sektorin e bujqësisë. Së pari kam vërejtje në këtë sektor lidhur me investimet që kanë ndodhur. Nëse i shikojmë investimet që kanë ndodhur në bujqësi, bujqësia është shndërruar në ndonjë organizatë humanitare. Nuk ka program strategjik të zhvillimit, por më shumë është përqendruar në subvencione dhe ndihma, e cila dukuri kisha pasur dëshirë të ndryshojë!

Një gjë që duhet të ndryshojë është se drejtori i ka formuar dy kategori të shefave për sektor, shefat e sektorit dhe shefin e drejtorisë dhe nuk ka kuptim për mua të bëhet kjo ndarje!

Kjo nuk është detyrë e drejtorit ta bëjë këtë, sepse ky Kuvend ose kryetari duhet ta bëjë rritjen ose zvogëlimin e sektorëve.

Të njëjtat shqetësime i kam edhe unë lidhur me ndarjen e territoreve të gjuetisë si z. Sabedini, sepse kjo në Kuvend nuk ka kaluar dhe besoj se duhet të shqyrtohet në një seancë të radhës.

Jam befasuar lidhur me planifikimin, sepse drejtori thotë se nuk e dimë buxhetin për vitin e ardhshëm kalendarik dhe nuk jemi të saktë në projekte? Nuk guxojmë të hyjmë në një vit kalendarik për pa i pasur të precizuar çdo aktivitet.

Izmi Zeka- drejtori nuk mund të merr vendim për asgjë që nuk ka kompetencë, prandaj nuk ka mundur ta bëjë as ndarjen e territoreve për shoqatat e gjuetarëve, prandaj kjo duhet të silllet në Kuvend dhe këtu të merret vendimi.

Abdyl Aliu- së pari dua të them se sa herë të kemi raporte të tilla jam i mendimit se duhet të shkojnë në komitetet përkatëse, pastaj të sillen në Kuvend.

Nga disa drejtori ka raporte dhe me mangësi teknike, por edhe profesionale, sepse tek disa raporte ka vetëm tekst, kurse i mungojnë tabelat dhe grafikonet.

Te Shërbimi Autoparkut, është një përshkrim i mirë i detyrave, por nuk ceket se cila kompani e bënë servisimin e automjeteve? Mirëpo në raport nuk del asnjë cent për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve? Lidhur me këtë duhet shtruar pyetje, kjo punë bëhet gratis, apo bëhet pagesa prej xhepit të vozitësve!

Mandej nuk ceket cila kompani bënë sigurimin e automjeteve, por nuk ka asnjë të dhënë lidhur me sigurimet e auto mjeteve! Thuhet se janë shitur dy automjete dhe një është blerë për QKMF, por këto transaksione nuk figurojnë në raport! Mandej thuhet se gjendja e këtyre automjeteve është e mirë, por shumica e tyre harxhojnë vaj!

Në tabelë ka edhe defekte të tjera automjeti me nr. 6 ‘Fiat’ thuhet në periudhën janar- dhjetor ka kaluar 161 km dhe për këtë periudhë ka shpenzuar afër 55 litra benzinë? Me këtë kuptohet se ky automjet shpenzon mbi 36 litra në 100 km. Gjithashtu ky automjet për këto km i ka bërë 25 larje! Sipas kësaj në çdo 6.5 km është pastruar ky automjet. Mirëpo edhe me automjetin nr. 11 ka ndodhur kështu dhe kështu me radhë ndodh edhe me automjete të tjera.

Në Drejtorinë për Financa, sa i përket taksave komunale nga bizneset shihet se nuk është realizuar ajo që është planifikuar, por nuk është edhe keq, sepse janë realizuar afër 95%.

Dallim i madh është inkasim nga lejet e punës, sepse realizmi është përmbush vetëm 28% nga plani i paraparë. Sa i përket zhvillimit ekonomik nuk është shkruar asnjë fjalë, sepse nuk ka zhvillim ekonomik, por zhvillimi ekonomik as nuk gjenden në agjendën e punës për vitin 2001.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, në raport ka mjaft aktivitetet dhe punë në lidhje me urbanizmin e qyteti, por për mbrojtje të mjedisit nuk ka asnjë fjalë dhe mjedisi po degradohet çdo ditë. Edhe unë edhe drejtori urbanizmit kur vijmë në punë ndeshemi me dy deponi ilegale në “Zabelin e Sahit Agës” dhe tërë atë që e ka bërë inspeksioni është një tabelë kut thuhet: “ndalohet hedhja e mbeturinave”, por fatkeqësisht deponi të tilla ka edhe në pjesë të tjera të qytetit.

Tefik Ibrahim- z. kryesues kriteret të vlejné për të gjithë njësoj dhe kërkoj që në të ardhmen të dihet se sa parashihet të flasin shefat e grupeve dhe sa këshilltarët dhe atij principi t’i përmbahemi.

Unë lidhur me raportin konsideroj se është bërë një punë e suksesshme, sepse të udhëhiqet me një komunë ku nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka prodhim dhe nuk ka eksport, por jetohe vetëm nga tatimet dhe taksat dhe dhuruesit, atëherë kuptohet se është bërë një punë e madhe.

Unë i kam dy-tri pyetje: Cila është arsyeja që nuk është përmendur iniciativa për hapjen e Universiteti publik në Komunën e Gjilanit? Unë mendoj se kjo iniciativë ka qenë desh të procedohet edhe nga KK- i Gjilanit?

Jam në dakord me atë që tha se nuk jam i kënaqur me ato mjete të cilat i ka ndarë qeveria për Komunën e Gjilanit, sepse janë premtuar 100 milion euro për 4 vjet dhe sipas kësaj për vitin 2010 ka qenë desh t’i investojë 25 milion euro në Gjilan! Mirëpo kjo nuk ka ndodhur, prandaj kryetari duhet t’ia përkujtoj, kryeministrit se një premtim të tillë e ka dhënë para të gjithë qytetarëve të Gjilanit.

E treta, kryetari i përmendi disa punë kryes të dështuar, prandaj nuk e di pse të thuhet se janë në listë të zezë, kur janë organet kompetente për zgjidhje të këtyre problemeve?

Saradnë Bllaca- në raport thuhet se është punuar me agjendë të rregullt të punës së komiteteve, mirëpo lidhur me këtë kam vërejtje, por edhe te Drejtoria e Arsimit. Ky Kuvend vitin e kaluar ka themeluar 9 komitete prej të cilave 2 janë obligative, kurse 7 jo obligative. Përbërja e këtyre komiteteve ka qenë 100% me ligjin dhe rregulloren e këtij Kuvendi. Në këto raste nuk është përfill kriteri gjinore dhe kjo është shkelje e ligjit që në fillim të vitit. Është shkel rëndë ligj dhe qysh në fillim të viti nuk është përfill kërkesa e jonë!

Mirëpo komitetet edhe pse janë formuar ato nuk kanë qenë funksionale sa duhet, por disa shumë pak. Komiteti për Arsim ka qenë fare pak funksional, sepse gjatë tërë viti 2010 i kemi mbajtur vetëm katër takime, por edhe komitetet e tjera nuk janë në gjendje më të mirë.

Vërejtjet në arsim i kam dhënë në komitet, por këtu po shtoj janë marrë masa disiplinore dhe gjatë vitit janë përjashtuar nga shkolla 14 nxënës nga Gjimnazi dhe 5 nga Shkolla e Mesme Teknike, të cilat të dhëna ka qenë desh të figurojnë në raport.

Izmi Zeka- nuk e kam të qartë se sa është thyerje e ligjit te barazia gjinore, por po e them se unë nuk mund të sjelli emra këtu, ajo varet nga vet juve ! Ju i sillni emrat ne i bëjmë plotësimet.

Funksionimet e komiteteve varet prej kryetarëve, fajtor janë kryesuesit për të gjitha komitetet, sepse nuk i kanë funksionalizuar si duhet.

Ibish Ibishi- sa po vërej unë në këtë Kuvend, kërkesat tona nuk merren seriozisht dhe shumë herë nuk merren në shqyrtim. Është mirë që ato kërkesa të cilat ne i parashtrijmë këtu të merren në shqyrtim, sepse edhe ato vijnë prej qytetarëve.

Raportet të cilat i kemi ne, janë dërguar për t' i analizuar se çka është punuar, çka nuk është punuar dhe duhet të punohet, kurse këtu ne jemi të obliguar të japim vërejtje, sugjerime, por edhe falënderime për punën e mirë e cila është bërë. Unë kërkoj që në të ardhmen të jemi më të shkurtër në diskutimet tona, por sugjerimet dhe kërkesat të merren parasysht.

Raporti i kryetarit është për t' u përshëndetur, por kjo nuk do të thotë se nuk ka asnjë vërejtje e për mua ajo më madhja është tek projektet të cilat dështojnë ose degradohen pas një periudhe të shkurtër kohore për të cilin rast fajësohet organi mbikëqyrës. Unë nuk e lë fajtor krejtësisht këtë organ, sepse ky komision emërohet nga institucioni, por i cili në shumë raste dhe nuk është profesional. Për të ardhmen kërkoj që të kemi kujdes kur të caktohen këto organe mbikëqyrës për mos të ndodh ajo që e thash më parë, që mos të ketë dështime të projekteve.

Kryetari disa punë kryes i vlerësoi si të përmirësuar pas dhënies së punëve në raundin e dytë dhe të tretë, por me këta duhet pasur një kujdes më të veçantë, sepse punë kryesi e ekzekuton punën. Këtë po e them se po të ishim më syçelë, pusetat e kanalizimit do të ishin të rregulluara ashtu si duhet e jo siç janë tash dhe paraqesin rrezik për qytetarët.

Ne raportin e kryetarit e përshëndesim, por në raporte të drejtorive kemi gjetur edhe punë të mira, por i kemi edhe vërejtje tona. Tek Administrata kemi një ngritje të shpenzimeve të karburanteve dhe kjo është për 3117 litra më tepër se vitin e kaluar.

Drejtorja e Shëndetësisë, nuk ka dhënë fare raport financiar, mirëpo kjo drejtori duhet pasur në konsideratë edhe zgjerimin e punkteve shëndetësore edhe në vende të tjera ku është popullata më e dendur dhe e koncentruar me numër më të madh.

Do të them diçka për urbanizmin gjegj këtë drejtori me inspeksionin dhe me zyrtarët e planit hapësinor ose mjedisit të cilët duhet të kenë në përkujdesje mjedisin në të cilin ne po jetojmë.

Këtë po e them, sepse kemi hedhje të mbeturinave vend e pa vend të cilën çështje e kam ngrit edhe njëherë në Kuvend.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike f.1 numri i projekteve të realizuara, ndërrimi i trafostacionit në fshatin Bresalc dhe në fshatin Shillovë. Ndërrimi i këtij trafostacioni në Bresalc me të njëjtat të dhëna ka kushtuar mbi 6100 euro, kurse në Shillovë mbi 18 mijë euro. Këtu sipas të dhënave këta trafostacione janë të njëjtë, por nuk e kam të qartë në Shillovë janë vendosur tre të tilla apo çka ka ndodhur?

Po në këtë drejtori kam vërejtur se projektet më të mëdha janë kontraktuar me kompani jashtë Gjilanit siç janë disa tenderë për kanalizim dhe ujësjellës.

Drejtori i Bujqësisë ka pasur një kërkesë për ta sjell një raport për shpërndarjen e farës së grurit për mbjellje, por ky raport nuk na është sjell asnjëherë!

Gjithashtu në këtë drejtori ka qenë edhe një projekt për ngritjen e pemishteve të reja, i cili projekt ka pasur vlerën 20 mijë euro, për të cilin projekt ne nuk kemi njohuri se çka ka ndodhur?

Në emër të grupit të AAK-së kërkoj një raport të detajuar për seancë të radhës, lidhur me këtë projekt për ngritje të pemishteve të reja.

Bahrie Veseli – u theksua më parë, se në raportin e kryetarit të Komunës, Zyra për Barazi Gjimore nuk ekziston fare dhe shumë rrallë është përmendur vetëm kalimthi. Nuk dihet se kjo zyrë a ka buxhet dhe si funksionon? Gjithashtu nuk ka të dhëna se çfarë aktiviteti ka bërë gjatë vitit të kaluar, por as nuk ka plan për vitin e ardhshëm?

Kam vërejtje në Drejtorinë e Arsimit, sepse së pari regjistrimi i nxënësve që nga klasa e parë nuk është bërë ashtu si duhet, sepse nuk është respektuar fare rajonalizmi të cilin e kemi votuar këtu?

Në Shkollën e Velekicës 20 nxënës gjithnjë qëndrojnë në oborr dhe pengojnë procesin mësimor, kurse personeli mësimor dhe drejtori janë të pafuqishëm për të ndërmarr diçka?

Në gjysmë vjetorin e dytë në Shkollën “A. Ajeti”, mësimi nuk është mbajtur asnjë ditë! Në këtë shkollë dihet se problemi i ngrohjes është evident qysh moti, por nuk është marrë asgjë për ta eliminuar këtë problem.

Në “A. Ajeti” mësimi nuk është duke u mbajtur fare, nxënësit shkojnë, vijnë, kurse llogari nuk jep askush!

Gjithashtu në këtë vit është formuar një panel për intervistim të kuadrit mësimor, por nuk e di kush e ka formuar? Kjo është përgjegjësi e këtij Kuvendi! Në këto panele duhet patjetër të jetë përfaqësimi gjinor.

Punëtorët teknik janë ata që kompensohen më së paku, kurse në anën tjetër kanë sipërfaqe të madhe për mirëmbajtje të pastërtisë, prandaj kur të ndërtohet ndonjë aneks shkollor duhet të rritet numri i punëtorëve të tillë.

Lidhur me Teatrin kam një pyetje se a është ndërmarrë diçka që Teatri dhe sipërfaqja e tij t’iu kthehet atyre që iu takon, sepse dihet se një pjesë të tij shfrytëzohet nga njerëz jo kompetent.

Në vitin 2011 nuk e pashë se ka plane për ndarje të bursave për nxënës dhe studentë të dalluar!

Ibrahim Neziri- ne e përshëndesim raportin e kryetarit, por i kemi dy çështje: njëra është një informatë në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe ud. të drejtorëve të shkollave në gjuhën serbe, sepse ka qe 3-4 muaj janë zgjedhur këta ud. Gjithashtu në raport janë mungesat e nxënësve, por nuk janë evidentuar në raport mungesat e mësimdhënësve? Mirëpo duhet të thuhet edhe diçka edhe për punën e drejtorëve të shkollave si njerëz përgjegjës për shkolla.

Tahir Arifi- unë përshëndes raportin e kryetarit, duke vlerësuar shkoqitje që ia ka bërë atij raporti para nesh. Këto raporte nuk duhet vetëm të lexohen, por do të duhej të jepej ndonjë sugjerim me mundësitë që ne i posedojmë.

Mbështesë z. Arbenin plotësisht i cili sugjeroj që të bëhet një hyrje e rrugës edhe nga ana e Preshevës dhe i propozoj kryetarit që ta ushtrojë ndikimin e tij për ta bërë këtë realitet dhe të hyjë si prioritet.

U fol lidhur me regjistrimin në shkolla të mesme, ku me të vërtetë ka probleme dhe sugjeroj DA që të bëjë një komision i cili do t’i shihte profilet në të cilat nxënësit kanë më pak interesim për t’u regjistruar, sepse askush më nuk dëshiron të shkojë në drejtim të lavërtarisë në Shkollën e Bujqësisë. Këtu duhet bërë një kamuflim dhe ai emërtim ka mundësi të funksionalizohet me një emërtim tjetër.

Tek palestra nëse thuhet diçka për qira, unë e di se është fjala për fushën jashtë e cila shumë kohë ka qenë e pashfrytëzuar dhe aty është një pishinë për të cilin ka ekzistuar një ide që ajo të funksionalizohet dhe të jepet me qira dhe me këtë do të mbuloheshin shpenzimet e palestrës.

Kam sugjerim se punëtorët e Teatrit nuk janë as shërbyes civil, por as profesionistë të cilët marrin disa paga përmes subvencioneve, por unë kërkoj që të shqyrtohet mundësia që ata të futen në listë ose si shërbyes civil ose si punëtorë profesionistë siç janë punëtorët e arsimit.

Si ide mendojmë se trupa profesioniste muzikore duhet të ndodh dhe mendoj se hapat e parë duhet t’i bëjmë dhe ta shohim se si do të shkojë puna?

Mendoj se punëtorë e bibliotekës më duket janë të vetmit që koeficientin e pagës e kanë gjashtë.

Do të theme se mësimdhënësit e Shkollës “A. Ajeti” janë shumë të ndërgjegjshëm, edhe sikur mos të kishte institucione, ato do t’i kryenin punët e veta me ndërgjegje.

Sallën e Teatrit e menaxhon trupa profesioniste e qytetit, por duhet rishikuar edhe hapësirat e tjera të cilat nuk janë të definuara.?

Shpresë Kurteshi- unë u përqendrova më tepër në raportin e DA-së dhe e shikova notën mesatare të arsimit fillor dhe atij të mesëm. Në arsimin fillor nota mesatare është më mirë, kurse në arsim të mesëm nuk është edhe aq mirë. Është dukuri se në gjysmë vjetorin e parë nota mesatare është më ulët, kurs enë fund të vitit ajo dukshëm po rritet.

Dëshiroj që të epet një sqarim pse po ndodh kjo, sepse ne po dyshojmë në një fryrje të suksesit? Shqetësim tjetër është mosfunksionimi i komiteteve të cilin rast e paraqiti kolegja Sarandë. Mirëpo këtu u tha se fajet qenkan tek kryesuesit e komiteteve, prandaj le të merret ndonjë masë ndaj tyre ose të bëhet ndërrimi i tyre!

Leonorë Bunjaku- mua më duket se në përgjithësi, raporti ishte i kompletuar, por po theksoj se duke marrë parasysh zhvillimin e hovshëm të teknologjisë dhe reformat që po ndodhin në arsim, por të cilat në vazhdimësi do të ndodhin, mendoj se duhet të investojmë në vazhdimësi në ngritjen profesionale të mësimitdhënësve.

Një hap i tillë veç është ndërmarrë, sepse e dimë se është organizuar kursi i informatikës, por tek mësimitdhënësit edhe njohja e gjuhës angleze është shumë e nevojshme. Me këtë po e theksoj se kjo është një punë e cila mund të realizohet dhe është në të mirë të gjithëve.

Mirëpo unë i mbështesë ato që i thanë koleget, sepse këtu nuk po ekzistuaa barazi gjinore, por kjo padrejtësi është bërë më së shumti në kuadër të grupit tim G-3. Në këtë grup i kemi 5 komitete dhe nuk është e përfaqësuar asnjë femër edhe pse kemi femra me aftësi shumë profesionale në këtë grup.

Izmi Zeka- unë do të them në fund se fare pa qenë raporti, po të shikojmë viti prej vitit do të vërejmë sa ka dallime! Shikoni ndryshimet në investime, shikoni reformat çfarë janë bërë në Administratë! Çdo gjë në Gjilan ka ndryshuar, por mos të kuptohet se çdo gjë është e përsosur , por çdo ditë po bëhen ndryshime.

Nuk duhet të theksohen vetëm anët negative, prandaj e konsideroj se është bërë punë e mirë në vitin 2010, ka pasur investime edhe nga buxheti vetanak, grandit qeveritar dhe prej dhuruesve të ndryshëm.

Gjithashtu edhe përqendrimi i ynë ka qenë që kompanitë gjilanasë të jenë më tepër përfituese të tenderëve, por ekziston një ligj që e rregullon këtë çështje.

Prej kësaj seance duhet të dalim me një bindje se ky vit ka reflektuar shumë pozitivisht dhe është bërë një punë jashtëzakonisht e suksesshme.

Fjalën ia barti kryetari të Komunës, të cilin e lus që të jetë sa më i shkurtër dhe sa më efikas .

Qemajl Mustafa- unë i kam shënuar të gjitha vërejtjet e juaja, por ka shumë të përsëritura dhe për të qenë më ekspeditiv, nëse e jap një përgjigje, për të njëjtën nuk ndalem tek tjetri.

Është thënë se raporti duhet t' i drejtohet KK-së, por duhet ta dini se raporti është vetëm i kryetarit i cili raport epet në çdo gjashtë mujor (dy herë në vit).

Pat vërejtje hyrja në Spitalin Regjional, është çështje e një niveli tjetër, do të thotë e nivelit qeveritar, por unë jam në komunikim të mirë me drejtorin dhe do të bisedojmë për këtë rast.

Lidhur me Administratën janë bërë përparime të dukshme, krahasuar me atë fundin e vitit 2007 dhe fillimin e kësaj qeverisje dhe nëse diku janë bërë përparime të dukshme ato janë bërë tek Administrata. Mirëpo me siguri ka edhe ndonjë mungesë, mandej defekte të teknologjisë dhe mund të ketë ngecje për ndonjë ditë a periudhë të caktuar për shkak të mbingarkesave etj.

Pajtohem me atë se raportet duhet të jenë më informuese dhe me statistika të duhura dhe të jenë me përmbajtje të tillë që sa më shpejtë këshilltari ta merr informacionin e duhur.

Në SHC nuk ka pasur bastisje, sepse bastisja edhe si terminologji i takon një akti tjetër, por ka pasur kërkesë për ta marrë dokumentacion në SHC për tri lëndë, bazuar në dyshimet që janë ngrit për disa zyrtar në qeveri.

Ky dokumentacion është kërkuar për tri projekte: për atë të mirëmbajtjes verore të rrugëve, për projektin e rrugës: Përlepnicë- “Vali ranxh” dhe atë të rrugës “Jugu-1”.

Unë e ndiej veten shumë të përgjegjshëm dhe nuk e ndiej veten të akuzuar, gjithashtu edhe znj, Hatixhe nuk është e akuzuar, por Prokuroria e ka ngritur një dyshim bazuar po quaj në thash e theme, të cilat do të sqarohen së shpejti.

Borxhet që u përmenden janë aspekt financiar dhe këtu nuk do të ndalem, sepse raportin financiar do ta keni dhe do të debatojmë për këtë.

Mirëpo tek investimet kapitale jemi shumë në obligime, sepse kemi filluar shumë projekte, prej të cilave një pjesë e mirë është paguar prej Qeverisë, kurse një pjesë ka mbetur për pa u paguar e cila shumë sillet afër 3 milion, por ato janë çështje të Qeverisë, kurse Komuna pak merr pjesë në ato.

Fare nuk qëndron ajo që e thotë Arebni se çdo komision është i zgjedhur politikisht, prandaj edhe ju u bindët se në komisionet mbikëqyrës, ka shumë kuadro nga subjektet e tjera politike.

Por edhe jam shumë i bindur se nuk ka pasur mundësi dikush të kompensohet në atë shumë që u përmend 20-30 euro dhe nuk do ta gjeni një rast të tillë, por nuk do ta gjeni as deri në 10 mijë euro dhe ne jemi munduar që punën t’ia distribuojmë të gjithëve.

U tha diçka për hapësirat publike? Pajtohem plotësisht me këtë, sepse për hapësirat publike ka të drejtë DSHP së bashku me mua t’i jep në shfrytëzim vetëm në afate të shkurtra, vetëm 12 muaj.

Ky është qëndrim ekzakt i imi. Është bërë një tejkalim tek kafeneja në qendër pa dijen time, por ai vendim suspendohet, sepse është dhënë për 36 muaj, pa lejen time nga ish drejtori i SHP.

Ajo kafiteri është dhënë për 12 muaj, por shfrytëzimi është sezonal dhe vetëm për muajt e verës dhe në asnjë mënyrë tjetër. Kjo do të demolohej deri në fund të verës.

Ajo pjesa e Teatrit do të lirohet së shpejti, sepse veç e kemi arrit marrëveshjen, por edhe ajo pjesa të TMK, është storje e mbyllur, sepse ne kemi desh që hapësirat që janë të pashfrytëzuara t’i funksionalizojmë përkohësisht.

Aty ka ardhur investimi nga Komisioni Evropian dhe ajo ndërtesë demolohej gjatë muajit shkurt, deri në mes të marsit dhe ajo pjesë bëhet e gatshme për bibliotekë e cila është duke u projektuar.

Investimi prej 11 milion euro, unë jam për qartësi që e përmendi Arbeni, por e tërë parinë publike që ne e procedojmë dhe e shpenzojmë nuk është tek menaxherja e prokurimit znj. Hatixhe, por ajo që nuk është proceduar tek ne ajo nuk e ka në raporte, por ne e kemi si informacion. Kështu ka të drejtë Arbeni, sepse ne duhet t’i bashkojmë të dyja ato dhe ta kemi një informacion i cili do të del tek ajo shuma 11 milion. Aty nuk i kemi shkolat, ndërtesën e banimit social dhe ndonjë aspekt tjetër i cili është publikuar nga qeveria.

Nuk qëndron ajo se gjëja kompanitë e Gjilanit nuk janë trajtuar, sepse kompanitë e Gjilanit kanë marrë punë ekskluzivisht në Gjilan, me përjashtim të atyre tenderëve të cilët janë shpallur në qeveri dhe të cilat janë tenderë mjaft të vëllimshme.

Mirëpo duhet thënë se kompanitë në Gjilan nuk janë treguar se janë të konsoliduara dhe nuk janë dëshmuar se mund të jenë konkurrense.

Pakot ushqimore dhe shpërndarja e druve është bërë me transparencë të madhe, të cilat janë të nënshkruar nga komisioni, por ky komision ka hasur në disa raste shumë të rënda në terren dhe

me lejen time iu është bërë ndarja edhe atyre familjeve, por në asnjë mënyrë në baza politike. Ne regjistrin e posedojmë dhe kush të dojë mund ta vërtetojë.

Klubet sportive që të gjitha janë asistuar në mënyrë të barabartë, por më vjen keq që nuk kemi krijuar njëfarë kriteriumi, sepse ato të gjitha nuk e kanë të njëjtin kualitet dhe nuk garojnë në të njëjtin nivel. Ia kemi paguar kuotizimet dhe disa shpenzime minimale.

Jam shumë i bindur se nuk ka klub i cili ka qenë i licencuar e nuk ka marrë nga pak.

Deponia e qyteti e dini se është kompetencë e Qeverisë, por ju e dini se ne kemi insistuar gjatë tërë këtyre viteve që kjo deponi të kalojë si kompetencë në nivel të rajonit, sepse ne do ta mbajmë shumë më mirë.

Nuk ka degradim të projekteve ashtu siç thuhet, por ka ndonjë pjesë të projektit, përveç rrugës për Gumnishtë në të cilën rrugë është një dëmtim më i dukshëm, kurse të tjerat janë pëlcitje të vogla të rrugëve dhe ujësjellësve etj.

Grandi qeveritar- ky grand është në dy pjesë, është ai themelor, i cili projektohet në buxhetin bazë i cili është miratuar në këtë Kuvend dhe ai është korrekt i cili është bazuar në numrin e banorëve të një komune dhe territorin e saj. Mirëpo është e vërtetë se Komuna e Gjilanit nuk është trajtuar në mënyrën meritore, sepse kanë shkuar investime më tepër në disa komuna dhe regjione të tjera, për të cilin fakt do të kemi pretendime ta korrigjojmë këtë vit dhe ta marrim pjesën e cila na takon.

Tek Administrata ka mund të ndodh ndonjë gabim teknik, sepse drejtori është shumë pedant dhe raportet i ka shumë në rregull.

Tek autoparku u dhanë disa vërejtje, por kështu gjërat nuk shikohen, sepse për një veturë për të cilën u fol "Llada", ajo është veturë jofunksionale dhe sipas raportit nuk është e tëra shpenzim, sepse disa qindra litra gjendet në rezervuarët e automjeteve.

Për arsimin i fol gjatë, por e kam thënë se mund të ketë për ndonjë ditë apo periudhë që do të ketë ndonjë pengesë të cilat ndonjëherë janë edhe të paparapara, por aty duhet të jemi tolerant dhe DA dhe ne të gjithë duhet të bëjmë përpjekje për ta sanuar. Unë jam i sigurt se ka ndonjë të metë, sepse është drejtori shumë e madhe.

Më bëri përshtypje fjala e Mimosës e cila tha se shumë ftohtë është në Palestër, por kjo nuk guxon të ndodh, sepse në vitin 2009 këtu i kemi investuar 60 mijë euro për nxehje e cila nuk ka funksionuar mbi 10 vjet. Gjithashtu me 60 mijë euro të tjera e kemi rregulluar kulmin e kësaj palestere dhe kemi bërë edhe renovime të tjera. Këtu nuk guxon të jetë temperatura nën zero absolutisht asnjëherë. Ju faleminderit Mimosë për këtë informacion!

Punësimi i drejtorëve paraprak u tha nga Rashiti nuk po ndodh, por kjo po ndodh, por vetëm drejtorin e Gjimnazit nuk e kemi punësuar, sepse nuk ka orë, por të cilit ia kemi punësuar bashkëshorten. Kam pasur kujdes të veçantë që ish drejtorëve t' i bëj zgjidhje!

Në integrimin e komuniteti serb është bërë përparim dhe tash po thuaj se të gjithë pranojnë për t' i nënshkruar kontratat me DA, për të cilin rast e kemi hapur një konkurs për ta rishqyrtuar atë gjendje, kurse romët janë në sistem edhe pse punojnë jashtë objekteve shkollore.

Është thënë se zhvillimi ekonomik nuk figuron në Drejtorinë e Financave, mirëpo ka qenë një periudhë kur kjo veprimtari nuk ka pasur mundësi të funksionojë, sepse nuk ka pasur donacione dhe donatorë të interesuar, por tash në ndërkohë kemi filluar për ta themeluar atë njësi, por edhe ka pasur zhvillime dhe nuk mund të themi se nuk ka pasur zhvillime.

Unë po e them hapur kushtet për investime Kosova nuk i kemi ndërtuar.

Është thënë se nuk figuron iniciativa për hapje të Universitetit, por ne kemi bërë një punë shumë të mirë për t' i zgjeruar disa salla, për ta bërë zërimin dhe për të filluar puna sa më shpejtë. Nuk e kam në raport, sepse këso akte ka pasur mjaft dhe ai raport do të ishte edhe më i gjatë.

Pse punë kryesit nuk paditën në gjykatë? Për këtë po e them se përgjegjësia është administrative te Komuna e nëse vlerësojmë se tek ndonjëri i ka tejkaluar kushte dhe ajo të jetë juridike, atëherë ajo kalon në instancë të gjyqësisë.

Pasi që jem në fund unë do të dëshiroja që për secilën drejtori në ndonjë seancë të veçantë dhe secilën zyrë ta mbajmë ndonjë seancë edhe pse kjo nuk është me ligj. Por në këtë rast koha duhet të jetë e limituar, por dhe qasje dashamirëse. Informacionet që janë sjell prej drejtorive janë informacione të cilat iu shërbejnë juve të gjithëve dhe për herë të parë po dëgjoj që edhe këshilltarë që i takojnë bllokut qeverisës e kritikojnë qeverisjen? Kjo është kualitet i ri siç ishte pak Arbeni dhe më shumë Sabedini etj. Secili prej këshilltarëve duhet ta thotë atë që mendon, për atë secili është këtu.

Ju kisha lut në fund nëse rastësisht kemi tejkaluar diçka po iu lus që të na drejtoheni me shkrim! Në fillim të seancës nuk propozohen gjërat, grupet politike me letër tek kryesuesi dhe kryetari i dërgojnë çështjet tri ditë përpara. Thirrret grupi i caktuar i cili kërkon për ta vu një çështje dhe kështu bëhet një marrëveshje.

Paneli për intervistim është bërë në baza ligjore, por mua më vjen keq që aty nuk ka ndonjë femër, do të duhej të jetë një femër dhe duhet ta merrni në konkurset e ardhme. Kjo është kritikë me vend, por ne kemi vendosur njerëz të kujdesshëm me përvojë në arsim dhe me kualitete.

Ju faleminderit për durimin që patët, por po them se ka mjaft për t' i përmirësuar dhe korrigjuar, por po iu lus kështu si jeni sot edhe pa letra dhe vetëm me një sms ose telefon, unë do të përpiqem që ta bëj atë që është në dorën dhe autorizimin tim.

Drejtori i Inspeksionit e ka kryer punën me shumë dinjitet dhe seriozitet së bashku me atë bujqësisë dhe çdo respekt kam për punën e tyre.

Selver Xehlili- desh të them diçka lidhur me pyetjet e znj. Mimosë dhe Shpresë. Unë tek raporti im e kam debatuar dhe kam pasur kontakt me drejtorin e Departamentit të Kulturës të cilët atë që e kanë premtuar edhe është realizuar se do ta bëjnë një investim prej 500 mijë euro.

Sa i përket pastërtisë tek Palestra e Sportit nuk e kam pasur asnjë ankesë prej klubeve sportive dhe gjithmonë kanë qenë të kënaqur. Unë e kam bërë një kërkesë te kryetari që mirëmbajtjen dhe pastërtinë e Palestrës ta merr një komani private për shkak se ka shumë klube të cilat i zhvillojnë aktivitete aty? Te nxehja është me të vërtetë një shqetësim, por të hyrat në këtë palestër janë zero dhe kjo palestër për një orë i shpenzon 100 litra derivate.

Brenda viti 2010 kanë qenë dy shfaqje “Lulja dhe Shega” dhe “Sfinga e gjallë”

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovet raporti i kryetarit të Komunës?

Aprovohet Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2010 me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime

3/2- Propozim –vendimi për kompensimin e Kolegjiumit të shefave të grupeve të këshilltarëve dhe për caktimin e anëtarëve të KK-së, në komisionet mbikëqyrëse, pranime teknike të projekteve kapitale dhe të komisioneve tjera të KK-së

Izmi Zeka- pjesa e dytë e kësaj pike, sipas konsultimeve që pat amë zyrtarin ligjor dhe kryetarin e Komunës, kjo pjesë është në kundërshtim me ligjin, por i cili ka mbetur për të biseduar me

Zyrën Ligjore në nivel të vendit dhe eventualisht nëse ekziston mundësia ligjore, atëherë do ta rikthejmë në Kuvend. Për pjesën e parë është çështje e Kuvendit.

Qemajl Mustafa – për pjesën e parë që ishte një stimulim për shefat e grupeve, unë nuk jam kundër, sepse nuk është ndonjë shpenzim i madh vjetor, por mendoj se dhe e meritojnë, sepse kanë përgjegjësi për bërje të politikave dhe iu duhen takime më të shpeshta.

Ajo pjesa tjetër është ndërhyrje flagrante në ligj dhe është ndërhyrje ligjore e Kuvendit në punët e prokurimit dhe absolutisht ajo nuk qëndron. Shpenzimet buxhetit duhet bërë në rrugë tenderuese dhe konkurruese dhe kjo do të kalojë në kompetencë të një kompanie.

Ne mund ta bëjmë një marrëveshje interne me kompaninë, për hir të ruajtjes së kuadrit i cili është profesional dhe i nevojshëm.

Zijadin Maliqi-unë e lexova propozim vendimin dhe e kam të qartë se pjesa e dytë është në kundërshtim me ligjin dhe kjo punë që është bërë që 2-3 vjet ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Mbikëqyrja ka qenë joprofesionale dhe ka pasur raste kur edhe me shkollë të mesme ka pasur në komisione të tilla, kurse ligjin tash e kemi. Mirëpo edhe tek e para nuk kam asgjë kundër rritjes për shefat e kolegjiut, por po habitem me ata se si nuk po mendojnë për pjesën tjetër të këshilltarëve të cilët gjenden këtu me votën e dikujt!

Disa këtë e kanë si pagë të dytë, por jemi disa të cilët e kemi si pagë të vetme pagën e këshilltari komunal. Është mirë që së paku të bisedohet edhe për rritje të pagës bazë të këshilltarëve.

Izmi Zeka – në takimin e kryesuesve të Kuvendit në nivel të Kosovës, është kërkuar nga Qeveria që kjo çështje të shqyrtohet. Ne do të kërkojmë përsëri një rritje për këtë qëllim, por kjo nuk është kompetencë e jona.

Elisah Ymeri – a ka mundësi që kjo të precizohet mirë, sepse pasi e kemi propozuar e kemi parë se është në kundërshtim me ligjin dhe mos të dalim jashtë ligjit! Nëse është në kundërshtim me ligjin ne nuk kemi pse të humbim kohë.

Izmi Zeka- propozoj që për shefat e grupeve të jetë kompensimi 70 euro si pjesë shtesë për angazhim të tyre (shtesë mujore). Kush është për këtë propozim?

Aprovohet propozim- vendim 3/2 me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Me këtë pikë të rendit të punës seanca përfundoi punimet

Seanca përfundoi punimet në ora 17.45 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Z. Izmi ZEKA